

6UDHËZUES PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR DËM

Të nderuar Infermierë,

Në rast të ndodhjes së një ngjarjeje të siguar, ju lutemi ndiqni hapat e mëposhtëm për të mundësuar trajtimin sa më të shpejtë dhe efikas të kërkesës suaj për dëm.

Hapi 1 – Njoftoni kompaninë

Njoftoni kompaninë për rastin sa më shpejt që të jetë e mundur pas ndodhjes së ngjarjes në email-in zyrtar info@savajete.com.

Gjatë njoftimit, ju lutemi të jepni:

- Emrin dhe mbiemrin;
- Numërin Personal;
- OIK;
- Datën dhe vendin e ngjarjes;
- Përshkrim të shkurtër të rastit;
- Numrin tuaj të kontaktit.

Hapi 2 – Plotësoni formularin e kërkesës për dëm

Për të filluar procedurën e shqyrtimit të kërkesës, ju lutemi të plotësoni formularin për paraqitjen e kërkesës për dëm, duke dhënë të gjitha të dhënat e kërkuara në mënyrë të saktë dhe të plotë.

Formulari mund të merret:

- në zyret tona;
- në zyret e OIK;
- ose të shkarkohet nga faqja jonë zyrtare.

Hapi 3 – Dorëzoni dokumentacionin

Dokumentet duhet të përfshijnë:

- Kopje të dokumentit të identifikimit;
- Raporte mjekësore;
- Fatura dhe dëshmi pagesash;
- Raporte policore (kur kërkohet);
- Certifikata përkatëse;
- Dokumente të tjera që lidhen me rastin.

Kompania mund të kërkojë dokumentacion shtesë nëse është i nevojshëm për shqyrtimin e kërkesës.

Hapi 4 – Verifikimi i kërkesës

Pas pranimit të dokumentacionit:

- Verifikohet mbulimi i kërkesës sipas kushteve të policës së sigurimit. Pas pranimit të dokumentacionit, Kompania do t'ju dërgojë në adresën tuaj elektronike (e-mail) një konfirmim për pranimin e kërkesës dhe dokumentacionit.
- Shqyrtohet dokumentacioni i dorëzuar.
- Nëse gjatë shqyrtimit konstatohet se nevojitet dokumentacion shtesë, Kompania do t'ju njoftojë me e-mail për dokumentet që duhet të plotësohen ose dorëzohen, në mënyrë që procedura e trajtimit të kërkesës të vazhdojë.

Hapi 5 – Vendimarrja

Kompania do të shqyrtojë kërkesën për dëm dhe do të marrë vendim **brenda afatit maksimal prej 30 (tridhjetë) ditësh**, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëm dhe pranimit të dokumentacionit të plotë.

Pas përfundimit të shqyrtimit:

- Nëse kërkesa aprovohet, do të realizohet pagesa e dëmshpërblimit në përputhje me kushtet e policës së sigurimit.
- Nëse kërkesa refuzohet ose aprovohet pjesërisht, klienti do të njoftohet me shkrim për vendimin dhe arsyet përkatëse.

Kohëzgjatja e trajtimit

- Konfirmimi i pranimi të kërkesës për dëm do t'i dërgohet klientit jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit.
- Kompania do të shqyrtojë kërkesën për dëm dhe do të marrë vendim brenda afatit maksimal prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, duke filluar nga data e pranimi të dokumentacionit të plotë.
- Pas aprovimit të kërkesës për dëm, pagesa e dëmshpërblimit do të realizohet brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve të punës nga data e marrjes së vendimit për aprovimin e kërkesës.

Shënim: Nëse gjatë shqyrtimit konstatohet se dokumentacioni i dorëzuar nuk është i plotë, Kompania do ta njoftojë klientin me shkrim për dokumentacionin shtesë të nevojshëm. Në këto raste, afati për marrjen e vendimit fillon të rrjedhë nga data e pranimi të dokumentacionit të plotë.

Këshilla për Infermierët

- ✓ Njoftoni rastin sa më shpejt.
- ✓ Dorëzoni dokumentacion të plotë dhe të lexueshëm.
- ✓ Ruani kopjet e të gjitha dokumenteve.
- ✓ Mos jepni informata të pasakta ose të paplota.
- ✓ Mbani të përditësuara të dhënat tuaja të kontaktit.

Si mund të na kontaktoni?

 K.S.J SAVA JETË, Sheshi Nëna Tereza 33

 038 228 808

 info@savajete.com

 www.savajete.com

 Menaxheri i Kontratës , DITAR BASHOLLI 049 752 666

Dokumentacioni sipas llojit të kërkesës për dëm

Lloji i dëmit	Dokumentacioni kryesor
Vdekje	Certifikata e vdekjes; dokument identifikimi; dokumentet e trashëgimtarëve ose përfituesit; dokumentacioni mjekësor mbi shkakun e vdekjes; raporti i autopsisë/obduksionit (kur është kryer); raporti policor dhe dokumentacioni nga organet kompetente në rast të vdekjes si pasojë e aksidentit.
Invaliditet i përhershëm	Raportet mjekësore; epikriza; vendimi i komisionit kompetent mjekësor (kur aplikohet); dokumentacion tjetër mjekësor që vërteton shkallën e invaliditetit.
Sëmundje kritike	Raporti specialistik me diagnozën përfundimtare; rezultatet e analizave dhe ekzaminimeve diagnostike; epikriza; dokumentacioni tjetër mjekësor përkatës.
Hospitalizim	Raporti i pranimit dhe lëshimit nga spitali (epikriza); dëshmi mbi kohëzgjatjen e hospitalizimit; faturat dhe dëshmitë e pagesës, nëse mbulohen sipas kushteve të policës.
Aksident	Raportet mjekësore; raporti policor ose dokumentacioni nga organet kompetente (kur aplikohet); dokumentacion tjetër që vërteton rrethanat dhe pasojat e aksidentit.

Shënim: Lista e mësipërme paraqet dokumentacionin bazë që kërkohet sipas llojit të dëmit. Në varësi të natyrës së rastit dhe kushteve të policës së sigurimit, Kompania mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë për shqyrtimin e kërkesës.

Qëllimi ynë është trajtimi i drejtë, transparent dhe sa më i shpejtë i çdo kërkesë për dëm.

Faleminderit për besimin tuaj!